

Veprimi i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Kosovë*



Procedura e re standarde e punës për ofrimin e kujdesit shëndetësor në burgje
200 kopje të përdorura nga të gjitha burgjet,
80% e personelit të Departamentit të Shëndetësisë në Burgje të trajnuar



2 programe trajtimi të të burgosurve (të burgosurit afatshkurtër + afatgjatë),
20 facilitatorë të trajnuar dhe janë testuar programet në
2 burgje

200+ punonjës të burgjeve kanë mësuar për konceptin e sigurisë dinamike në burgje
Siguria dinamike është kur punonjësit në burg zhvillojnë dhe mbajnë marrëdhënie të mira me të burgosurit dhe angazhohen në dialog kuptimplotë dhe konstruktiv me ta



200 punonjës shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë të burgjeve kanë mësuar për etikën mjekësore, kujdesin e shëndetit mendor, regjistrimin e lëndimeve që tregojnë keqtrajtim, sëmundjet e transmetueshme dhe parandalimin e vetëvrasjes

3 Udhëzime administrative të hartuara:

- 1) Rekrutimi i personelit,
- 2) Procedurat dhe masat disiplinore për të burgosurit, dhe
- 3) Mekanizmi i ankesave dhe apelimit për të burgosurit



Mjeti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



zbatuar Nga Këshilli i Evropës

* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Veprimi i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Kosovë*

Projekti është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës si pjesë e "Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë", me qëllimin e përgjithshëm për ta rritur mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të burgosurve në përputhje me KiE-në dhe në veçanti me Komitetin Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KPT). Përfitues të projektit dhe partnerët ishin Ministria e Drejtësisë (MD) - Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) dhe Inspektorati i Brendshëm i Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë (MSH) - Departamenti i Shëndetësisë në Burgje (DSHB), Ombudspersoni dhe Mekanizmi Parandalues Nacional dhe shoqëria civile. Kohëzgjatja e projektit ishte 23 muaj, nga 01 Tetori 2016 deri më 31 Gusht 2018, dhe ishte nisur zyrtarisht më 07 Nëntor 2016. Buxheti i përgjithshëm ishte 620.000 EUR.

Projekti arriti tri rezultatet kryesore të vendosura në fillim. Domethënë, ai kontribuoi në rritjen e profesionalizmit të stafit të burgjeve, duke përfshirë stafin menaxherial; përforcoi më tutje masat mbrojtëse që synojnë sigurimin e mbrojtjes më të mirë të të drejtave të të burgosurve; dhe, përmirësoi ofrimin e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë kujdesin për shëndetin mendor dhe zbatimin e etikës mjekësore në burg.

Rezultatet janë prodhuar dhe dorëzuar në përputhje me planin e punës dhe pa vonesa, përmes zbatimit të aktiviteteve të ndryshme, si misionet e vlerësimit, trajnimet, sesionet e hartimit të ligjeve, grupet punuese dhe punëtoritë. Gjithsej 45 ekspertë të lëndës, ndërkombëtarë dhe vendorë, ndihmuan në zbatimin e suksesshëm të projektit, ku u përfshinë më shumë se 800 zyrtarë, personel korrektues dhe shëndetësor, inspektorë të burgjeve, si dhe staf nga Institucioni i Ombudspersonit dhe shoqëria civile.

Këto veprime janë karakterizuar nga një sërë arritjesh pioniere, si zhvillimi i mjeteve të vlerësimit të riskut dhe nevojave dhe programeve të trajtimit të të burgosurve, strategjisë për parandalimin e vetëvrasjeve, Procedurave Standarde të Punës për ofrimin e kujdesit shëndetësor në burgje, modulën e trajnimit për konceptin e Sigurisë Dinamike, zhvillimin e metodologjisë së punës dhe mjeteve për Inspektoratin e Burgjeve dhe manualin e trajnimit për kujdesin shëndetësor mendor. Gjithashtu, është ndihmuar në pilotimin e suksesshëm të dy programeve të trajtimit për të burgosurit në dy institucione burgu me gjithsej 60 seanca të zbatuara. Projekti më tej ka përmirësuar kapacitetet e DSHB-së në lidhje me ofrimin e kujdesit shëndetësor mendor të burgosurve, parandalimin e sëmundjeve të transmetueshme, etikën mjekësore dhe regjistrimin e lëndimeve që tregojnë keqtrajtim.

Mjeti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

zbatuar nga Këshilli i Evropës

* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.